



Organization for Security and Co-operation in Europe Presence in Albania

**Press and Public Information Office
*Zyra e Shtypit dhe Informacionit Publik***

RAPORT PËRMBLEDHËS MBI NDËRMJETËSIMIN NDËRKOMBËTAR NË PËRGATITJEN E ZGJEDHJEVE VENDORE 2000

25 Korrik 2000

Ky raport është një përshkrim i bazuar në fakte mbi zhvillimet e kaluara në lidhje me zgjedhjet e ardhshme vendore. Ai u hartua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri duke u bazuar në të dhënat më të sakta që kishte në dispozicion.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Deri në verë të 1999-s, gjashtë nga shtatë vendet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) ishin plotësuar nga organet e përcaktuara në Kushtetutën e 1998-s. Vendi i shtatë, emërimi i dytë nga Kuvendi, mbeti i lirë. Në atë kohë, Partia Demokratike nuk ishte e pranishme në Kuvend.

Emërimet vijuan me një polemikë në rritje midis partive të opozitës dhe të mazhorancës qeverisëse. Opozita kritikoi si procedurat e emërimit ashtu edhe vetë emërimet në KQZ.

Prezenca e OSBE-së u përpoq të ndërmjetësonte në këtë debat rreth KQZ-së. Dorëheqjet vullnetare nga ana e anëtarëve të emëruar të KQZ-së, dukej se ishin e vetmja rrugëdalje e ligjshme. Mbas bisedimeve të shumta ndërmjet Kryetarit të Prezencës, dhe përfaqësuesve të lartë të Shtetit dhe të partive politike, dy anëtarë të KQZ-së dhanë dorëheqjen në javën e parë të prillit 2000. Pra, mbetën tre vende të lira gjithsej. Një dorëheqje e tretë siç u morr në konsideratë gjatë këtyre bisedimeve, nuk u realizua. Sipas mendimit të disa politikanëve shqiptarë zgjidhja ideale do të kishte qenë dhënia e dorëheqjes në mënyrë vullnetare nga të gjithë anëtarët dhe riemërimi i kandidatëve me të vërtetë të paanshëm në vend të tyre. Megjithatë, mazhoranca qeverisëse nuk e morri këtë mundësi në konsideratë.

Mundësia e dytë më e mirë, nga ky këndvështrim, do të kishte qenë një KQZ “e ekuilibruar”, e përbërë nga anëtarë zyrtarisht jo-partiakë, por të cilët de facto do të ishin “të pranueshëm” për partitë qeverisëse dhe të opozitës. Anëtarë të pranueshëm nga opozita do të ishin emëruar në vendet e lëna të lira si pasojë e dorëheqjeve vullnetare. Por edhe kjo mundësi nuk u arrit të materializohej. Partia Demokratike deklaroi se ajo nuk do të jepte pëlqimin për një kandidat për KQZ-në, të cilin ajo nuk e njeht¹. PD-ja bëri deklaratatë të ngjashme në drejtim të Partisë Demokratike dhe Partisë së Legalitetit kur ato mendonin të propozonin ose faktikisht propozuan kandidatë.

Dy nga tre vendet e lëna të lira u plotësuan në fillim të qershorit mbas hyrjes në fuqi të Kodit Zgjedhor. Një nga emërimet u bë nga Presidenti. Ky ishte Klement Zguri, ish-anëtar i një partie të vogël opozitare, Partia e Ballit Kombëtar. Emërimi tjetër u bë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), Mimoza Arbëri, një juriste me qendër në Tiranë. Në mbledhjen e tij të parë të datës 12 qershor, KQZ-ja zgjodhi Fotaq Nanon Kryetar dhe, më 20 korrik zgjodhi Pali Xhelon Sekretar. Të dy këto emërimet janë kontestuar me pretendime për afërsi politike dhe personale me figura drejtuese të koalicionit qeverisës. Mbetet ende për t’u plotësuar vendi i zëvendës-kryetarit.

Që nga qershori, disa parti të vogla të së djathtës, si edhe institucione të shoqërisë civile kanë propozuar kandidatë për vendin e shtatë në KQZ, i cili i takon Kuvendit. Më 24 korrik, Kuvendi zgjodhi në këtë funksion Gaspër Kokaj, një profesor i së drejtës me bazë në Shkodër.

Kodi Zgjedhor

Më 21 shkurt, përfaqësues të partive parlamentare të koalicionit qeverisës dhe opozitës u mbledhën në selinë e OSBE-së në praninë e Komunitetit Ndërkombëtar, i përfaqësuar nga Kryetarët e Misionëve të Trojkës së Bashkimit Evropian, Shtetet e Bashkuara, dhe Kombet e Bashkuara (PNUD). Përfaqësuesit e partive vendosën të krijonin një grup pune në nivel ekspertësh për të rishikuar projektin qeveritar të Kodit Zgjedhor. Ky grup pune përbëhej nga pesë përfaqësues nga partitë e koalicionit qeverisës, pesë nga partitë opozitare dhe pesë nga institucionet ndërkombëtare. Këta të fundit ishin ekspertë të Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR), të Këshillit të Evropës, të Fondacionit Ndërkombëtar për Sistemet Zgjedhore (IFES-SHBA), si edhe të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Takimet e grupit të punës u zhvilluan në Prezencën e OSBE-së çdo pasdite duke përfshirë pothuajse të gjitha ditët e shtuna, nga data 8 mars deri më 7 prill. Një konflikt i hershëm rreth nënshkrimit të një marrëveshjeje, për barazi në të drejta dhe shanse në procesin zgjedhor, të kërkuar nga Partia Demokratike çoi në largimin e përfaqësuesve të opozitës nga këto takime në datat 10 dhe 11 mars. Mbas takimit të datës 11 mars midis Kryetarit të Prezencës dhe drejtuesve të Partisë Demokratike dhe të Partisë Republikane, opozita u kthye në tryezë në datën 13 mars.

¹ Shih. *Rilindja Demokratike, 6 Qershor 2000*

Duke filluar që nga data 1 prill, përfaqësuesit e opozitës e ndërprejnë pjesëmarrjen në grup, duke shprehur pakënaqësinë se kërkesat e tyre për një KQZ e cila do t'u garantonte partive përfaqësuesimin në të, nëpërmjet një sistemi pariteti nuk u plotësuan, dhe duke ritheksuar vërejtjet e tyre rreth barazisë së të drejtave dhe shanseve. Diskutimet vazhduan midis përfaqësuesve të partive të koalicionit qeverisës dhe të Komunitetit Ndërkombëtar deri më datën 7 prill. Ftesa drejtuar opozitës për pjesëmarrje mbeti e hapur gjatë gjithë procesit.

Më 10 prill, Kryetari i Prezencës i'a dorëzoi projekt-Kodin Zgjedhor Kryeministrit, meqënëse Këshilli i Ministrave kishte ndërmarrë hartimin e variantit të parë të tij. Të njëjtën ditë, një takim i Miqve të Shqipërisë shprehu vlerësimin e tij për punën e bërë nga grupi i punës dhe "mirëpriti faktin se tashmë një projekt-Kod i amenduar i ishte dorëzuar Qeverisë duke përfshirë ndryshimet e bëra me konsensus midis përfaqësuesve të partive politike si dhe propozimet e bëra nga ekspertët ndërkombëtarë". Dy përfaqësues të Opozitës u informuan rreth përmbajtjes së këtij projekt-Kodi të amenduar.

Këshilli i Ministrave e miratoi projekt-Kodin më 13 prill. Mbas një debati të gjerë, Kuvendi e aprovoi atë më datën 8 maj pa ndonjë ndryshim madhor, me përjashtim të dispozitave tranzitore (shih më poshtë pjesën mbi Nenin 153).

Me kërkesën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ligji u rishqyrtua nga ekspertët e disa institucioneve ndërkombëtare, të cilët, në parim e vlerësuan atë si një ligj cilësor dhe në përputhje me standartet ndërkombëtare. Këta ekspertë ishin Eugenio Polizzi nga Këshilli i Evropës, Pierre Garonne dhe Bernard Oëen nga Komisioni i Venecias të Këshillit të Evropës, Daniel Finn nga IFES-SHBA, dhe Joseph Middleton dhe Siri Skåre nga OSBE/ODIHR. Z. Finn përmbledhi pikëpamjet e tij për Kodin si më poshtë:

"Kodi është një skemë legjislative mjaft e zhvilluar që përbën një kod zgjedhor gjithëpërfshirës, për regullimin e zgjedhjeve brenda sferës së tij. Këshilli i Ministrave i Shqipërisë, i cili e ka propozuar Kodin; Kuvendi, i cili e ka miratuar atë; si dhe e gjithë Qeveria Shqiptare së bashku me personelin e saj dhe këshilltarët e jashtëm duhen përgëzuar për përgatitjen e një akti zgjedhor dhe ligjor kaq të zhvilluar".

Daniel Finn, Specialist Ligjor i IFES-it, 6 Qershor 2000

Neni 153 i Kodit Zgjedhor

Neni 153 është një dispozitë tranzitore, në Kodin Zgjedhor, dhe specifikon përbërjen e Komisioneve Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) dhe të Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) për zgjedhjet vendore të vitit 2000. Të gjithë këto komisione do të përbëhen nga përfaqësues të propozuar nga shtatë partitë që kanë fituar më shumë vota në *shkallë kombëtare* në zgjedhjet e fundit vendore të zhvilluara në 1996. Nenet e përhershme 38 dhe 43 parashikojnë se, përbërja e çdo KZQV dhe KQV duhet të pasqyrojë rezultatet e votimit në zgjedhjet e fundit vendore *për këshillin vendor përkatës*.

Kur OSBE-ja i'a dorëzoi projekt-Kodin Zgjedhor Kryeministrit më datën 10 prill, Neni tranzitor 153 nuk ishte pjesë e tij. Gjithashtu, projekt-Kodi kaloi në Këshillin e Ministrave pa ndonjë ndryshim të konsiderueshëm. Më 8 maj, OSBE-ja ishte e pranishme në Kuvend në ditën e fundit të debatit mbi Kodin Zgjedhor. Megjithatë, vlen të përmendet fakti se Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri nuk ishte i pranishëm në kohën e zhvillimit të këtij debati për arsye të një vizite zyrtare në Shtetet e Bashkuara. Gjatë debatit, përfaqësuesit e OSBE-së mësuan rreth ndryshimeve të propozuara mbi përbërjen e KZQV-ve në kohën kur atyre i'u dorëzua një kopje e disa projekt-amendamenteve të paraqitura në seancën plenare nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste. Përfaqësuesit e OSBE-së kërkuan një pushim dhe shprehën shqetësimin e tyre në një takim me Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e atëhershëm të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Gramoz Ruçi. Pas kësaj, u morrën dy masa. Masa e parë ishte që rezultatet në shkallë kombëtare të ishin të vlefshme vetëm për zgjedhjet vendore të këtij viti. Masa e dytë ishte që Gramoz Ruçi të shpjegonte gjatë debatit parlamentar më datën 8 maj se Neni 153 ishte i nevojshëm për shkak të ndryshimeve të planifikuara të ndarjes administrative-territoriale të Shqipërisë përpara zgjedhjeve.

Përfaqësuesit e OSBE-së të pranishëm në këtë diskutim nuk mbetën plotësisht të kënaqur me këto dy masa të marra. Qeveria u shpreh se ndryshimet administrative-territoriale rridhnin nga Kushtetuta, në kuadrin e deçentralizimit përpara zgjedhjeve. Më vonë ky argument u mbrojt nga përfaqësues të tjerë të qeverisë. Ministri i Pushtetit Lokal, Bashkim Fino u takua me Kryetarin e Prezencës më datën 23 qershor për të paraqitur plane rreth ndryshimeve specifike. Ndërkohë, Qeveria kishte deklaruar publikisht vendimin e saj për të shtyrë çdo ndryshim të kufijve administrativë deri pas zgjedhjeve.

Dy projekt-ligje mbi reformën administrative-territoriale janë tashmë në Kuvend por asnjë prej tyre nuk parashikon ndryshime në kufijtë vendore ekzistues. Njëri prej tyre përcakton qartë krijimin e njësive bashkiake me këshilla vendore dhe kryetarë brenda Bashkisë së Tiranës. Tjetri specifikon krijimin e Qarqeve në Shqipëri ashtu siç kërkohet nga Kushtetuta.

Eshtë argumentuar, veçanërisht nga ekspertë ligjorë, se në përgjithësi, duhet të shmangen ndryshimet e kufijve administrativo-territorialë në periudhën përpara ditës së zgjedhjeve. Shtimi i Neni 153 në Kodin Zgjedhor u kritikua nga disa ekspertë zgjedhorë, veçanërisht nga Këshilli i Evropës. Argumenti i tyre kryesor ishte se përbërja e uniforme e komisioneve zgjedhore vendore mund të cënonte partitë e vogla me një fokus rajonal dhe nuk perputhej me kërkesat për autonomi vendore të parashikuara në Kartën Evropiane për Vetë-Qeverisjen Vendore.

Rregjistrimi i Votuesve

Misioni i Vëzhgimit të Rregjistrimit të OSBE-së siguroi vëzhgim të vazhdueshëm të rregjistrimit derë-më-derë nga 3 qershori deri më 11 korrik 2000, në kuadrin e Programit të Asistencës Zgjedhore (PAZ). PAZ-i është një program i filluar me nismën e PNUD-it me synimin për të asistuar Qeverinë Shqiptare me përgatitjet teknike për zgjedhjet dhe i

financuar nga një numër vendesh dhe organizatash ndërkombëtare. Në përgjithësi, u arrit qëllimi i zhvillimit të një regjistrimi transparent dhe të saktë, dhe në përgjithësi, procedurat e reja për regjistrimin e votuesve e përmbushën qëllimin e tyre për adoptimin e standarteve të pranuar ndërkombëtare. Pati disa mosmarrëveshje dhe vonesa, por në pjesën më të madhe në nivel vendor, u vu re se zyrtarët bënë gjithçka ishte e mundur me një angazhim të konsiderueshëm. Bënë përjashtim qytete më të mëdha si Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Kukësi dhe Lushnja, ku polemikat dhe bllokimet politike penguan në mënyrë të konsiderueshme proceset teknike. Regjistrimi në Lushnje është ende i bllokuar si rezultat i një konflikti për zëvendësimin e kryetarit të bashkisë, i cili i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese nga Këshilli Bashkiak i Lushnjës dhe i cili ka tërhequr gjithashtu vëmendjen e Këshillit të Evropës. Një Raport Përfundimtar i Vëzhgimit do të dalë në fund të korrikut.

Monitorimi i Zgjedhjeve

Zgjedhjet e ardhshme vendore janë të një rëndësie të veçantë për arsye të reformës së thellë të legjislacionit dhe procedurave zgjedhore që ka filluar në Shqipëri, dhe për arsye të zhvillimeve politike në vend. Për këtë arsye, OSBE-ja vendosi qysh herët t'i kërkojë OSBE/ODIHR-it të bëjë një përjashtim në rregullin e saj të përgjithshëm të monitorimit vetëm të zgjedhjeve kombëtare, për të organizuar një mision të plotë vëzhgimi për këto zgjedhje.

OSBE/ODIHR-i, me përvojën e tij të gjatë në monitorimin e zgjedhjeve kombëtare dhe vendore në Rajon dhe në Shqipëri, pranoi kërkesën e Qeverisë së Shqipërisë për të vendosur një mision të gjerë prej më shumë se 20 Vëzhguesish Afat-Gjatë nga fundi i Gushtit, dhe prej 150 Vëzhguesish Afat-Shkurtër në fund të Shtatorit. Ekziston një marrëveshje midis Këshillit të Evropës dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara për të bashkëpunuar në monitorimin e zgjedhjeve dhe bashkërendimin e ngushtë të këtyre përpjekjeve. Këshilli i Evropës planifikon të dërgojë 10 - 15 Vëzhgues Afat-Shkurtër.

Përfundime

Meqenëse na ndajnë vetëm dhjetë javë nga zgjedhjet vendore, është e një rëndësie vendimtare që KQZ-ja të përmbushë plotësisht detyrimet e veta. Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor e ngarkojnë KQZ-në me rolin drejtues për të organizuar dhe drejtuar këto zgjedhje. Në të njëjtën kohë, duhet të vendosen mekanizmat vëzhgues kombëtare dhe ndërkombëtare të parashikuara nga ligji.

Në mënyrë që të jetë i aftë për të përmbushur detyrat e tij, Komisioni kërkon si mbështetje financiare ashtu edhe teknike nga institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare sa më shpejt që të jetë e mundur. Gjithashtu, dispozitat ligjore mbi rolin e KQZ-së në përgatitjen e zgjedhjeve dhe marrëdhëniet e tij me Programin e Asistencës Zgjedhore kanë nevojë që të përcaktohen qartë.

Një nga detyrat madhore që kemi përpara është krijimi i KZQV-ve deri në fillim të Gushtit, në mënyrë që strukturat zgjedhore vendore të mund të trajnohen dhe të jenë të afta të funksionojnë efektivisht për përgatitjen dhe drejtimin e zgjedhjeve.